



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.121**

**22 gusht**

**2009**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr.763, datë 11.6.2009

Për disa shtesa në vendimin nr.80, datë 28.1.2008, të  
Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë sektoriale  
të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit, për zbatimin e  
saj”, të ndryshuar .....

5777

**VENDIM**  
**Nr.763, datë 11.6.2009**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.80, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SEKTORIALE TË MBROJTJES SOCIALE DHE TË**  
**PLANIT TË VEPRIMIT, PËR ZBATIMIN E SAJ”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjes Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.80, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale, që i bashkëlidhen vendimit, pas kapitullit 6 shtohet kapitulli 7, me titull “Dokumenti i politikave ndërsektoriale për moshën e tretë”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në planin e veprimit të strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale, që i bashkëlidhet vendimit, shtohet aneksi nr.2, me titull “Plani i veprimit për politikat ndërsektoriale të moshës së tretë, për periudhën 2009-2013”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**MBI PROCESIN HARTUES DHE KONSULTATIV TË DOKUMENTIT NDËRINSTITUCIONAL**  
**ZHVILLUES PËR MOSHIMIN**

Procesi hartues dhe konsultativ i DNZHM-së ishte një proces i hapur dhe gjithëpërfshirës. Me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nr.1426 datë 14.7.2008 u ngrit grupi i punës, i cili ishte përgjegjës për grumbullim e informacionit, përzgjedhjes së tij, si dhe përpunimin e materialeve dhe të dhënave më të përditësuara në mënyrë që në këtë dokument të paraqitet situata aktuale dhe problemet reale të të moshuarve në përputhje, gjithashtu, edhe me prioritetet e Qeverisë. MPÇSSHB-ja ka qenë përgjegjëse për miratimin e përmbajtjes së dokumentit, kontaktimin e institucioneve përgjegjëse, koordinimin, si dhe vlerësimin e performancës së anëtarëve të grupit të punës.

Me qëllim konsultimin e Dokumentit Ndërsektorial Zhvillues, u ngrit një grup konsultativ i përbërë nga ekspertë të cilët përfaqësonin: Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Integritimit, Ministrinë e Financave, Institutin e Shëndetit Publik, Institutin e Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor. Grupit konsultativ kontribuo i me sugjerime dhe komente të vlefshme në vlerësimin real të nevojave dhe kërkesave të të moshuarve për respektimin e të drejtave të tyre në këtë dokument, si dhe planveprimin e tij.

Një falënderim i veçantë shkon për Qendrën Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), duke ofruar bashkëpunimin më të mirë të mundshëm si facilitues të procesit të hartimit të dokumentit. ACER veproi si koordinator, duke ofruar ndihmë logjistike, aftësi menaxheriale, organizative, planifikim strategjik dhe menaxhim të burimeve në bashkëpunim me të gjitha palët në këtë proces.

Falënderimi shkon gjithashtu në adresë të të gjithë ekspertëve, intervistues në terren, të 12 prefekturave të vendit, të cilët me profesionalizëm mblodhën të dhënat e një formulari shumë voluminoz, në lidhje me nivelin e garantimit të të drejtave dhe plotësimit të nevojave të personave të moshuar.

Ky dokument nuk do të ishte i plotësuar pa kontributet e përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe OJQ-ve aktive në këtë fushë, të cilat u mbledhën në një workshop për të shprehur vlerësimet e tyre konkrete mbi dokumentin në fjalë. Inputet e palëve të interesuara në këtë proces i dhanë Dokumentit Ndërsektorial Zhvillues të Moshimit një dimension gjithëpërfshirës.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të konsultuar për këtë qëllim janë organizatat joqeveritare: ASET, Qendra për Gratë dhe Vajzat- Kombin, Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale, Shoqata e Pensionistëve, Shoqata Shqiptare e Gerontologji- Geriatri, Shoqata Shqiptare e Demografëve, Shoqata “Për nxitjen e zhvillimit të gerontologjisë”, ASAG, Qendra Komunitare për të Moshuarit, Gruaja Kryefamiljare, si edhe përfaqësues të pushtetit lokal: Bashkia Tiranë/sektori i shërbimeve sociale, njësia bashkiake nr.5, njësia bashkiake nr.2, njësia bashkiake nr.7 etj.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile diskutuan me anëtarët e grupit të punës për përmirësimin e mëtejshëm të dokumentit, në të cilin vlerësohej përfshirja e sa më shumë institucioneve përgjegjëse në zbatimin e planeve të veprimit të sugjeruara nga ky dokument, si dhe trajtimi i një sërë problemesh sociale si: varfëria, izolimi, shërbimet shëndetësore, solidariteti ndërmjet brezave, edukimi i brezit të ri, asistenca sociale etj.

Procesi i hartimit të Dokumentit Ndërsektorial Zhvillues ka gjetur miratimin e të gjitha palëve të interesuara në adresimin e problematikës dhe respektimit të të drejtave të të moshuarve në Shqipëri.

Hartimi i Dokumentit Zhvillues Ndërsektorial për Moshimin si një iniciativë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u mbështet nga UNFPA jo vetëm financiarisht, por duke ofruar edhe ekspertizë teknike.

#### LISTA E SHKURTIMEVE

|         |                                                                |
|---------|----------------------------------------------------------------|
| MPCSSHB | Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta |
| SHSSH   | Shërbimi Social Shtetëror                                      |
| OJF-të  | Organizatat jofitimprurëse                                     |
| MF      | Ministria e Financës                                           |
| MSH     | Ministria e Shëndetësisë                                       |
| MPB     | Ministria e Punëve të Brendshme                                |
| MPPTT   | Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit |
| METE    | Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës               |
| MTKRS   | Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve            |
| MBUMK   | Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit  |
| ISSH    | Instituti i Sigurimeve Shëndetësore                            |
| SKZHI   | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim                 |
| PAK     | Personat me Aftësi të Kufizuar                                 |
| NE      | Ndihma Ekonomike                                               |
| MD      | Ministria e Drejtësisë                                         |
| MASH    | Ministria e Arsimit dhe Shkencës                               |
| KM      | Këshilli i Ministrave                                          |
| OKB     | Organizata e Kombeve të Bashkuara                              |
| INSTAT  | Instituti i Statistikës                                        |
| ISHP    | Instituti i Shëndetit Publik                                   |
| IKSSH   | Instituti i Kujdesit dhe Sigurimit Shëndetësor                 |
| NJQV    | Njësia e Qeverisjes Vendore                                    |
| QCA     | Qendra e Cilësisë së Akreditimit                               |
| QSUT    | Qendra Spitalore Universitare                                  |
| ASHR    | Autoriteti i Shërbimit Rajonal                                 |

## KAPITULLI I

### SITUATA SOCIAL-EKONOMIKE E PERSONAVE TË MOSHUAR

#### Konteksti demografik

##### 1.1 Situata demografike

Popullsia e Shqipërisë aktualisht numëron rreth 3.2 milion banorë (INSTAT, 2007). Nga 1930-1990 popullsia e vendit është dyfishuar çdo 30 vjet. Tranzicioni demografik në Shqipëri është në fund të shtrirjes kohore të tij prej 80 vjetësh.

Koeficientët e vdekshmërisë dhe të lindshmërisë aktualisht janë të ulët. Koeficienti bruto i vdekshmërisë është i ulët dhe i pandryshueshëm që prej shumë vitesh, ndërkaq ka një tendencë rënieje edhe koeficienti i lindshmërisë.

Sipas regjistrimit të parë administrativ të popullsisë në vitin 1923, Shqipëria numëronte 804 mijë banorë ndërsa në vitin 2005 (pa emigracionin) llogaritej rreth 3 800 mijë banorë. Në këtë proces tranzicioni, popullsia e Shqipërisë gati është pesëfishuar.

Shqipëria njeh një tranzicion demografik të vonë dhe të shpejtë, pasi periodha e tranzicionit demografik është e shkurtër (80 vjet) dhe koeficienti i rritjes natyrore i lartë (mesatarisht 2% në vit). Në 80 vjet tranzicion (1920-2000) popullsia e Meksikës është rritur 7 herë; popullsia e Italisë për 89 vjet tranzicion (1876-1965) është rritur 2.3 herë; popullsia e Francës për 185 vjet tranzicion (1785-1970) është rritur 1.6 herë.

Lindshmëria. Politikat shtetërore të lindshmërisë deri në vitin 1990 kanë qenë nataliste. Rritja e popullsisë konsiderohej si faktor për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Kjo politikë gjeti terrenin e favorshëm të vlerave, normave sociale, kulturore dhe ekonomike në vend.

Me një popullsi gjerësisht rurale, njësia bazë e prodhimit ishte ekonomia familjare. Moshë e hershme e hyrjes së vajzave në martesë dhe niveli i ulët i edukimit krijonin një klimë të favorshme për ruajtjen e traditës lidhur me dimensionin e familjes. Një grua e moshës riprodhuese në atë kohë sillte në jetë mesatarisht 5.5 fëmijë.

Me gjithë politikën nataliste të shtetit, ku aborti dhe përdorimi i mjeteve moderne kontraceptive ishin të ndaluar, ritmet e rritjes së popullsisë që prej vitit 1960 filluan të ulen. Ky paradoks konfirmon faktin se një moral i imponuar nga shteti, por i padëshirueshëm nga qytetarët, pothuajse nuk ka shanse për të qenë i suksesshëm.

Pas 1990 ulja e koeficienteve të rritjes natyrore të popullsisë shpjegohet me uljen e nivelit të lindshmërisë, ndërsa koeficienti i vdekshmërisë pothuajse nuk ka ndryshuar.

Koeficientët e lindshmërisë kanë rënë ndjeshëm dhe kjo shpjegohet kryesisht me emigracionin e lartë të popullsisë në moshë riprodhuese, rritjen e nivelit të edukimit, rritjen e moshës mesatare të hyrjes në martesë të vajzave, kontrollin e lindjeve etj.

Vdekshmëria dhe zgjatja e jetës. Koeficienti bruto i vdekshmërisë vazhdon të jetë në nivele të ulëta për shkak të strukturës moshore të popullsisë dhe uljes së koeficientëve të vdekshmërisë tek të rriturit. Ndonëse koeficienti i vdekjeve është i ulët, koeficienti i vdekshmërisë foshnjore është i lartë, rreth 28 vdekje foshnjash për një mijë lindje të gjalla. Ky tregues është nga më të lartët në Europë.

Shqipëria është një vend me të ardhura të pakta ekonomike, por jo me jetëgjatësi të ulët. Ndonëse Shqipëria në 2005, përfshihet në grupin e vendeve me indeks të lartë të zhvillimit human, prodhimi i brendshëm bruto për banor është sa 22 % e vlerës së vendeve me zhvillim të lartë human.

Zgjatja mesatare e jetës në lindje në Shqipëri është 75.1 vjet: për meshkujt 72.1 dhe për femrat 78.6 vjet. Ky tregues është i krahasueshëm me mjaft vende të zhvilluara të Europës. Zgjatja mesatare e jetës në lindje është rritur me gati 22 vjet në krahasim me 1950 dhe 10 vjet jetë më shumë se në 1960. Në këtë kontekst çdo person që ka mbushur moshën 60 vjet ka shpresë për të jetuar edhe 20.6 vjet, ndërsa një person që ka mbushur 65 vjet, ka shpresë për të jetuar edhe 16.5 vjet. Ky progres shpjegohet kryesisht me përmirësimin shëndetësor, edukimin si dhe me dietën mesdhetare të jetesës. Në të ardhmen ndryshimet në zgjatjen e jetës nuk priten të jenë të ndjeshme pasi, realiteti tregon se ata që jetojnë 100 vjet e më shumë janë më me fat, por ata janë të paktë.

Migrimi dhe urbanizimi. Ndryshimet politike, ekonomike e sociale pas vitit 1990 u shoqëruan me lëvizje masive të njerëzve jashtë Shqipërisë dhe me shpërngulje masive brenda vendit.

Gati 1/5 e popullsisë së vitit 1989 ose mbi 700 000 persona u larguan nga Shqipëria në vitet 1991-2000 dhe jetojnë jashtë shtetit<sup>1</sup>. Emigracioni nga Shqipëria i përket veçanërisht grupmoshave të reja. Rreth 95 % e emigrantëve janë të grupmoshës 15-45 vjeç dhe gati 71 % janë meshkuj.

Migrimi brenda prefekturave përbën rreth 8% të popullsisë së vitit 1989 dhe prekin popullsinë e re aktive. Gati gjysma e migrantëve nuk kanë arritur moshën 30 vjeç në 2001. Vetëm 6% e tyre janë në moshën e pensionit. Këto lëvizje të brendshme, brenda një kohe të shkurtër kanë ndryshuar raportin midis popullsisë rurale dhe asaj urbane. Aktualisht 49% e popullsisë të vendit, banojnë në qytet nga 36% që ishte në vitin 1990.

Shpërnguljet më të mëdha të migrantëve të brendshëm u përkasin prefekturave të Dibrës, Kukësit dhe Elbasanit dhe janë vendosur më shumë në prefekturat Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Lezhë.

Struktura moshore e popullsisë. Shqipëria karakterizohet nga një popullsi me moshë relativisht të re. Gati gjysma e popullsisë është nën 25 vjeç. Moshë mesatare e popullsisë në 2007 ishte 32.5 vjeç nga 27.4 vjeç në 1990. Struktura moshore e popullsisë ka ndryshuar ndjeshëm. Në 2007, personat 65 vjeç e lart përbëjnë 9% të popullsisë gjithsej, mjaft më e ulët se në vendet fqinje dhe Europë që variojnë nga 15-20 %. Pjesa e popullsisë nën 15 vjeç është ulur ndjeshëm dhe përbën një të katërtën e popullsisë së vendit.

Në këto zhvillime demografike, popullsia e moshuar pritet të dyfishohet në 20 vjetët e ardhshëm. Ky moshim i popullsisë, përbën një sfidë për të ardhmen. Plakja e popullsisë ndikon mbi sistemin e pensioneve, shërbimet shëndetësore dhe produktivitetin ekonomik.

Në moshimin e popullsisë në Shqipëri ka ndikuar ulja e vdekshmërisë dhe zgjatja e jetës mesatare. Nga ulja e vdekshmërisë përftohen jetë njerëzore në të gjitha moshat. Për më tepër ulja e ndjeshme e vdekshmërisë foshnjore, rrit përpjesën e të rinjve në totalin e popullsisë. Moshimi i popullsisë është rrjedhojë jo vetëm i uljes së vdekshmërisë por dhe i uljes së lindshmërisë.

Vjetrimi i popullsisë e bën gjithnjë e më të vështirë financimin e pensioneve. Por problemi i pensioneve nuk mund të reduktohet në një dimension të vetëm demografik. Ulja e koeficientit të papunësisë dhe ulja e informalitetit në tregun e punës dhe produktivitetit të punës janë mundësi që zvogëlojnë peshën financiare të pensioneve për çdo person të zënë me punë. Kjo shtrton nevojën për të hartuar politika zhvillimi që integrojnë zhvillimet demografike.

## 1.2 Personat e moshuar dhe zhvillimi

1.2.1 Pjesëmarrja aktive në shoqëri dhe në zhvillim. Pjesëmarrja aktive e personave të moshuar në shoqëritë e zhvillim njihet si “shoqëri” për të gjitha moshat. Kjo përfshin krijimin e mundësive për personat e moshuar që të vazhdojnë të kontribuojnë në shoqëri dhe të jenë të integruar në procesin e zhvillimit të vendit.

Kontributi ekonomik e social i të moshuarve realizohet nëpërmjet rolit aktiv në proceset e zhvillimit në familje dhe në jetën ekonomiko-sociale të komunitetit. Në kushtet e sotme ata japin kontribute të rëndësishme në formë të ndryshme si: kujdesi për pjesëtarët e familjes, roli në punën produktive ndihmëse, në mbajtjen e ekonomisë së familjes dhe në veprimtaritë vullnetare në komunitet. Për më tepër, këto role kontribuojnë në përgatitjen e forcës së ardhshme punëtore.

Migrimi, urbanizimi, transformimi nga familje të mëdha në të vogla, familjet lëvizëse, mungesa e aksesit në teknologji, konsiderohen si faktorë që marginalizojnë të moshuarit, ndërsa përshpejtimi i zhvillimit ridimensionon pozitivisht rolin e tyre ekonomik e social.

1.2.2 Punësimi dhe personat e moshuar si forcë pune. Të punësuarit, sipas INSTAT-it, arrijnë në 935,058 persona ose 53.7% e popullsisë ekonomisht aktive. Papunësia që ekziston ndërmjet personave të moshuar ose afër kësaj moshe është shpesh papunësi afatgjatë dhe që përfundon me tërheqjen e tyre nga tregu i punës. Kjo lidhet me vështirësitë për të gjetur një punë të re kur kanë humbur vendin e punës së dikurshme.

Numri më i lartë i personave të moshuar të punësuar ose të vetëpunësuar i përket sektorit privat bujqësor. Kjo shpjegohet me lëvizjen e të rinjve nga zonat rurale dhe për pasojë me angazhimin e të moshuarve në veprimtari bujqësore të cilët përpiqen për të siguruar të ardhura për të kompensuar pensionet e ulëta dhe të ardhura të pamjaftueshme për një jetë më cilësore.

Në sektorin privat jobujqësor pjesëmarrja në punë e personave të moshuar është e konsiderueshme sepse: i) një pjesë e këtyre bizneseve janë familjare, ku angazhohen anëtarët e familjes dhe ii) përvoja e të moshuarve vlerësohet si avantazh specifik për sipërmarrjen.

<sup>1</sup> INSTAT, Repoba 2001

Personat e moshuar janë të përfshirë edhe në tregun informal sepse biznesi për këtë kategori nuk paguan sigurimet shoqërore. Pjesëmarrja e personave të grupmoshës afër 60 vjeç në tregun informal është relativisht më e ulët, ndërsa për grupmoshën 60 vjeç e lart rritet pjesëmarrja në tregun informal. Studimet dhe përvoja tregojnë se pjesëmarrja e personave të moshuar në tregun e punës ndryshon duke iu referuar karakteristikave individuale ku niveli arsimor është një faktor shumë i rëndësishëm, kështu punësimi i personave mbi 60 vjeç është më i lartë për ata që kanë një nivel të lartë arsimor.

### 1.3 Solidariteti ndërmjet brezave

Evoluimi strukturor i popullsisë në sensin e vjetërimit është i pashmangshëm; por shoqëria ka nevojë për solidaritet brezash për të gjeneruar integritimin dhe jo përjashtimin social. Mundet gjithnjë të vihen përballë njëra tjetrës “kapitali i përvojave dhe dijeve të fituara” të akumuluar nga më të vjetrit, me dinamizmin dhe krijimtarinë e më të rinjve. Mënyra sesi secili grup do ta trajtojë grupin tjetër, peshon fort mbi ekuilibrat socialë.

Në këtë mënyrë, presioni krijues i gjeneratave më të reja për të detyruar pjesën tjetër të popullsisë për t’iu përshtatur teknikave e teknologjive të reja, kthehet në faktor zhvillimi. Gjithashtu po të mbajmë parasysh që të moshuarit e sotëm janë në një gjendje më të mirë fizike dhe ndoshta edhe intelektuale se shumë dekada më parë (ata kanë një edukim më të gjerë dhe më shumë të shkolluar), bën që angazhimi i tyre të shkojë në favor të zhvillimit, shoqërisë dhe solidaritetit midis brezave.

Në emër të zhvillimit dhe të emancipimit shoqëror nuk duhen cenuar vlerat e krijuara e të ruajtura mirë si ajo e lidhjeve të brezave, për t’iu bashkuar Europës me vlerat tona më të mira.

Çdo brez mbështetet mbi kontribute të siguruara prej brezave të mëparshëm, duke përfshirë respektin e atyre që kanë ikur më përpara dhe në sensin e administrimit drejt brezave të ardhshëm.

Sipas vërtimit “Mbi problemet e moshimit”<sup>2</sup>, vihet re një tendencë për një familje të bashkuar në shoqërinë shqiptare.

- 42.4% e të anketuarve deklaroi se vazhdon të jetojë me fëmijët dhe 33.8% e tyre me bashkëshortin/in, ndërsa 19.7% janë të vetëm. Vetëm 3.9% jeton me një tjetër.
- mbështetja nga familjet për të moshuarit është tipari i solidaritetit. Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të tjerë të familjes sigurojnë të ardhura monetare për të moshuarit dhe vetëm 28.8% e tyre nuk sigurojnë të ardhura.

Solidariteti ndërbrezëror bazohet në shkëmbimin e njohurive dhe të eksperiencave, jo vetëm në një vend ose rajon, por në të gjithë botën. Pikërisht për këtë u arrit një konsensus ndërkombëtar me deklaratat e aprovuara të OKB-së, planet e veprimit që vijnë nga konferencat globale, duke përfshirë “Deklaratën politike & plani ndërkombëtar për veprim mbi moshimin”, Madrid 2002. Në kushtet aktuale të vendit tonë problemi i solidaritetit ndërmjet brezave në tërë kompleksitetin e tij, është në fillimet e veta. Nëpërmjet këtij dokumenti synohet të shtrohen disa nga drejtimit kryesore të ndërtimit të këtij solidariteti.

3

Të dhënat e vërtimit “Mbi problemet e moshimit”, tregojnë se qenia e bashkuar e familjes shqiptare bazohet dukshëm edhe në marrëdhëniet ekonomike brenda saj.

- 83.4% e të intervistuarve kanë në pronësi një banesë dhe vetëm 16.6% nuk kanë.
- solidariteti ndërbrezëror është përfshirja e të moshuarve në proceset vendimmarrëse në nivel vendor.
- 81.4% e të intervistuarve deklaroi se nuk përfshihen në proceset vendimmarrëse në pushtetin vendor dhe në komunitet. Në zonat rurale përfshirja ka tendencë të jetë më e madhe.
- në zonat rurale të moshuarit vlerësojnë familjen dhe aktivitete bujqësore si fushat kryesore ku mund të kontribuojnë;
- në zonat urbane të moshuarit janë më aktiv në shoqatat joqeveritare.
- 70.1% e të moshuarve rendisin familjen si fushën kryesore ku mund të kontribuojnë; 11.9% shprehen për angazhimin në punë; 11.6% pjesëmarrjen në shoqatat joqeveritare dhe 5.5% në jetën kulturore e shkencore.

### 1.4 Sigurimi shoqëror, mbrojtja sociale dhe parandalimi i varfërisë

Sistemi i sigurimeve shoqërore përbën një komponent të rëndësishëm për realizimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve. Pensionet janë elementi më i rëndësishëm i mbrojtjes sociale të të moshuarve. Aktualisht rreth 17 për qind e numrit të përgjithshëm të popullsisë përfitojnë pensione. Ky tregues ka prirje të qarta rritjeje. Për shkak të migrimeve të brendshme e të jashtme dhe i mendësive të reja në psikologjinë dhe në ekonominë e familjeve shqiptare, sistemi i

<sup>2</sup> Vërtim: “Mbi problemet e moshimit në mbështetje të hartimit të dokumentit strategjik të moshimit”, MPCSSHB, 2008,

<sup>3</sup> Vërtim: “Mbi problemet e moshimit në mbështetje të hartimit të dokumentit strategjik të moshimit”, MPCSSHB, 2008,

pensioneve edhe në të ardhmen do të luaj një rol të veçantë për mbështetjen e të moshuarve.

Në sistemin e skemës së sigurimeve shoqërore aktualisht përfitojnë:

- 527 000 persona përfitojnë pensione dhe kompensim të çmimeve të liberalizuara të energjisë elektrike dhe bukës;

- 110 000 pensionistë marrin kompensim për persona të varur ekonomikisht prej tyre;

- 23 000 veteranë dhe invalidë të luftës marrin pagesa të ndryshme;

- 7 400 invalidë të punës marrin pagesa të ndryshme;

- 20 000 të moshuar përfitojnë trajtim ekonomik nga skema e pensioneve të posaçme, pensione suplementare, skema e sigurimeve suplementare të ushtarakëve, përfitime të veçanta për minatorët, për familjet e dëshmorëve etj.

Me fondet e sigurimeve çdo muaj kalojnë në buxhetet familjare rreth 5.8 miliard lekë në muaj ose rreth 1.1 milion persona kontaktojnë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore për të përfituar pagesa e shërbime.

4

Niveli i ulët i pagesës së pensioneve ka detyruar një pjesë jo të vogël të të moshuarve të vazhdojnë të punojnë edhe pas daljes në pension.  
Sipas vërtetimit për problemet e të moshuarve rezultojnë se 40.5 % të intervistuarve në zonat rurale kanë punuar mbas daljes në pension ndërsa në zonat urbane, ky tregues është 28%.  
Të moshuarit meshkuj që vazhdojnë të punojnë janë 37.2% krahasuar me 26.4% tek femrat.

Sistemi i sotëm i mbrojtjes së të moshuarve me elemente të sigurimeve shoqërore ballafaqohet me probleme që lidhen me nivelin e pensionit minimal e mesatar, raportin e zëvendësimit, raportin e mbulimit, raportin e varësisë dhe raportin e numrit të përfituesve ndaj numrit të përgjithshëm të popullsisë.

Treguesit bazë të skemës së sigurimeve shoqërore

| Emërtimi                                  | 1994  | 2000  | 2005  | 2006  | 2007  |
|-------------------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Raporti i varësisë (përfitues/kontribues) | 0.96  | 1.05  | 0.64  | 0.76  | 0.61  |
| Qytet                                     | 0.71  | 1.05  | 1.02  | 0.89  | 0.87  |
| Fshat                                     | 3.62  | 1.04  | 0.36  | 0.57  | 0.36  |
| Norma e zëvendësimit                      |       |       |       |       |       |
| Qytet                                     | 69.14 | 53.07 | 47.17 | 48.00 | 48.39 |
| Fshat                                     | 34.59 | 17.93 | 27.93 | 30.70 | 33.51 |
| Norma e mbulimit                          | 33.76 | 38.98 | 78.47 | 65.82 | 76.66 |
| Përfitues/populli                         | 14.45 | 15.42 | 17.43 | 17.10 | 16.63 |

Burimi : ISSH

Koeficienti i zëvendësimit (raporti midis madhësisë së pensionit mesatar ndaj pagës mesatare), rezultojnë me prirje përqendrimi. Në qytet ky raport në vitin 1994 ishte 69,2%, ndërsa në vitin 2007 vetëm 48.4%. Në fshat në vitin 1994 ishte 34.5 %, ndërsa në vitin 2007 arriti në 33.5 %.

Koeficienti i mbulimit ( raporti i numrit të kontribuesve ndaj forcave të punës) po ashtu është në rënie, përkatësisht nga 33.76% në periudhën 1994-1999 në 76.6 % në vitin 2007. Vlerësohet se rreth 15 % e forcave të punës janë pa mbrojtje nga ky sistem.

Koeficienti i varësisë (raporti i përfituesve ndaj kontribuesve) është përqendruar deri në vitin 2002, por më pas ky tregues është përmirësuar .

Sistemi i pensioneve rezultojnë në pabalancuar. Megjithatë shkalla e zëvendësimit është mbajtur relativisht e ulët, sistemi i pensioneve rezultojnë me humbje. Deficiti nominal i skemës së pensioneve në 5 vitet e fundit, arrijnë mesatarisht në rreth 1.6% të PBB. Deficitin më të lartë e përbëjnë pensionet e fshatit.

<sup>4</sup> Vërtetimi: "Mbi problemet e moshimit në mbështetje të hartimit të dokumentit strategjik të moshimit", MPCSSHB, 2008,

### 1.5 Procesi i politikave sociale në Shqipëri<sup>5</sup>

Reformimi i sistemit të mbrojtjes sociale, decentralizimi, deinstitutionalizimi dhe ngritja e shërbimeve të reja komunitare, mbështetet në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” Objektivat e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale, Strategjisë ndërsektoriale të përfshirjes sociale 2007 – 2013 dhe Strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim (SKZHI).

Reformimi i sistemit synon: i) reduktimin e varfërisë në 10 % të popullsisë në 2013 kundrejt 18 % që është aktualisht; ii) përcaktimin e numrit të familjeve të varfra në përputhje me hartën e varfërisë (indikatore të LSMS 2002, 2005,2008); iii) mbulimin e nevojave me fonde buxhetore drejt 2\$ në ditë për person; iv) kushtëzimin e NE me punë komunitare dhe programe sociale ; v) dyfishimin e pagesave për familje në vitin 2009, trefishimin në 2010 dhe pesëfishimi në 2013.

Në kuadrin e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit është realizuar: i) kalimi i shërbimeve rezidenciale në administrim të njësive vendore. ii) zgjerimi i llojshmërisë së shërbimeve komunitare dhe mbulimi i të gjitha grupeve me shërbime bazë në të gjitha rrethet e vendit; iii) shtrirja e shërbimeve komunitare deri në vitin 2013 edhe në bashkitë që aktualisht nuk kanë shërbime të tilla; iv) pilotimi i shërbimit të kujdestarisë për fëmijët 2008-2010 në dy bashki (Tiranë, Shkodër); v) konsolidimi i modelit të shërbimeve “shtëpi-familje” për fëmijët dhe PAK, zgjerimi i këtyre shërbimeve edhe për të moshuarit; vi) implementimi i standardeve të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për të moshuarit, fëmijët, PAK etj. vii) licencimi i të gjitha OJF-ve që ofrojnë shërbime me klientët.

Për realizimin e këtij procesi janë bërë përmirësime ligjore, strukturore, organizative dhe janë përcaktuar qartë kompetencat midis nivelit qendror si politikëbërës dhe nivelit lokal si ekzekutues.

Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta harton legjislacionin, strategjitë, standartet e shërbimeve, vlerëson varfërinë dhe programon fondet, licencon dhe monitoron ofruesit e shërbimeve që operojnë në fushën sociale.

Shërbimi Social Shtetëror, si institucion ndërmjetës: i) vlerëson varfërinë dhe programon fondet për NE, PAK dhe shërbimet shoqërore; ii) monitoron dhe inspekton përdorimin e fondeve dhe zbatimin e standardeve të cilësisë së shërbimeve sociale; iii) përgjigjet për zbatimin e legjislacionit.

Njësitë e qeverisjes vendore marrin detyra të reja për identifikimin e familjeve dhe individëve në nevojë për NE, PAK, shërbime shoqërore dhe hartimin e kërkesave për fonde; ngrirjen e llojeve të reja të shërbimeve shoqërore në përputhje me nevojat e komunitetit; administrimin e institucioneve rezidenciale të shërbimeve dhe ndjekjen e shërbimeve në qendrat ditore dhe në komunitet; përzgjedhje, sipas prokurimit publik, të OJF-ve, ofruesve privatë të licencuar për ofrimin e shërbimeve shoqërore; kryejnë shpërndarjen e pagesave për NE, dhe PAK; grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave në strukturat qendrore etj.

Aktualisht në kuadrin e decentralizimit 19 shërbime rezidenciale kundrejt 26 gjithsej janë transferuar në pushtetin vendor. Shërbimet mbështeten me fonde, ekspertizë, monitorohet performanca e tyre.

U ngritën 43 shërbime komunitare me mbështetjen e B.B të cilat shtrihen në 8 qarqe dhe në 2 bashki/komuna, ku përfitues janë të moshuar, fëmijët, të rinjtë, PAK, gra dhe vajza të trafikuar. Këto shërbime ofrohen nga OJF-të.

Cilësia e shërbimeve garantohej me implementimin e standardeve të miratuara për: i) standartet e përgjithshme të shërbimeve shoqërore; ii) për fëmijët në institucionet rezidenciale e ditore; iii) për personat me aftësi të kufizuara; iv) për të moshuarit në qendrat rezidenciale & ditore si v) për viktimat e trafikut dhe vi) standartet e kujdestarisë për fëmijët në nevojë.

<sup>5</sup> Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013.

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Sipas vrojtimet shërbimi i punonjësve socialë vlerësohet kështu nga të anketuarit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-57.3% e konsiderojnë atë në nivelin mesatar, ndërsa 27.9% deklarohen si të kënaqur.</li> </ul> <p>Në zonat urbane 16.4% deklarohen të pakënaqur krahasuar me 10.8% nga zonat rurale.</p> <p>Për shërbimin e punonjësve të sigurimeve shoqërore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 48.8% e vlerësojnë shërbimin si të kënaqshëm dhe shumë të kënaqshëm,</li> <li>- 16.9% janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur. Në zonat urbane 40.4% japin vlerësim pozitiv krahasuar me 20.7 % të zonave rurale.</li> </ul> <p>Për shërbimin e punonjësve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 34.3% e vlerësojnë mesatarisht dhe</li> <li>- 52.1% janë të kënaqur ose shumë të kënaqur nga ai. Zonat urbane vlerësojnë më shumë shërbimin e ofruar.</li> </ul> |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Janë licencuar 102 OJF që ofrojnë shërbime sociale dhe janë institucionalizuar marrëdhëniet me shoqërinë civile. Është ngritur Inspektorati si strukturë e veçantë për kontrollin e zbatimit të standardeve.

#### 1.6 Zbutja e varfërisë në përgjithësi me ndikim në “moshën e tretë”

Personat e moshuar 65-vjeç e lart përbëjnë 7,5% të popullsisë së vendit<sup>7</sup>. Pesha specifike e personave<sup>8</sup> të moshuar ka tendencë rritje.

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Pavarësisht dinamikës relativisht të ulët të rritjes së pensioneve, sipas vrojtimet për problemet e moshimit, në krahasim me vitin e kaluar, vërehet një qëndrueshmëri në gjendjen ekonomike të të moshuarave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 46 % të anketuarve ndjehen njëllë nga pikëpamja ekonomike;</li> <li>- 42.4% ndjehen më keq dhe vetëm 11.1% ndjehen më mirë.</li> </ul> |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Për reduktimin e varfërisë në dhjetë vitet e fundit janë bërë përmirësime të rëndësishme për rritjen e pensioneve dhe zbutjen e diferencave midis grupeve të ndryshme të pensionistëve. (tabela..)

<sup>9</sup> Sipas vrojtimet “Mbi problemet e moshimit”, 31.9 % e të intervistuarve deklarojnë se kanë punuar edhe mbas daljes në pension (28 % në zonat urbane dhe 40.5% zonat rurale. Sipas statusit të punësimit, 84.6% e të intervistuar janë të papunësuar dhe vetëm 15.4% janë në punë. Arsytet e mos angazhimit në punë:

- 33.7% të rasteve nuk ndjehen të aftë nga ana shëndetësore;
- 23.2% nuk kanë mbështetje për mbarëvajtje në familje dhe
- 22% nuk kanë gjetur punë;
- arsyet të tjera “nuk janë lejuar nga pjesëtarët e familjes” apo “nuk kanë pasur nevojë të punojnë”.

#### 1.7 Shëndeti dhe mirëqenia për personat e moshuar

1.7.1 Akses i barabartë në shërbimet shëndetësore. Shkenca mjekësore ka siguruar mjete diagnostikuese dhe mjekuese duke minimizuar vdekjet e parakohshme. Por ndërsa futja e metodave të reja diagnostikuese dhe mjekuese ka pakësuar rrezikun e vdekjes së parakohshme, ka bërë fare pak lidhur me sëmundshmërinë dhe humbjen e autosuficiencës në moshë të avancuar. Humbja autosuficiencës dhe sëmundjet e lidhura me moshën e shkuar po konsiderohet “Epidemia e shekullit”. Në vendet e zhvilluara të moshuarit mbi 65 vjeç parashikohet të zënë 25% të popullsisë kundrejt rreth 7.5 % që është në Shqipëri.

Studimet demonstrojnë se 1/3 e të moshuarve janë të sëmurë apo vuajnë nga një sëmundje kronike. Rreth 24% e të shtruarve në spitale dhe 22 - 23% e vizitave mjekësore ambulatorie i përkasin moshës mbi 64 vjeç. Kjo prirje është drejt rritjes.

Zgjidhja e problemit të të moshuarve nga pikëpamja mjekësore nënkupton para së gjithash një shërbim preventiv, diagnostikim të hershëm, riaftësim dhe kura mendore e fizike që janë të veçanta për moshën e tretë deri në arritjen e shërimit apo autonominë e të moshuarit.

Sipas INSTAT-it prevalenca e të paktën një sëmundjeje kronike është 67% ndërsa me dy sëmundje kronike ishte 31%. Sëmundjet kronike më të shpeshta ishin kardio-vaskulare, diabeti dhe artriti reumatoid. Kjo strukturë parashikohet edhe në disa vite e mëvonshme.

<sup>6</sup> Vrojtimit: “Mbi problemet e moshimit në mbështetje të hartimit të dokumentit strategjik të moshimit”, MPCSSHB, 2008,

<sup>7</sup> INSTAT, 2007

<sup>8</sup> Vrojtimit: “Mbi problemet e moshimit në mbështetje të hartimit të dokumentit strategjik të moshimit”, MPCSSHB, 2008,

<sup>9</sup> I njëjti burim

Sipas vrojtimit për problemet e të moshuarve:

- 30% e të intervistuarve kërkojnë rritje të kapaciteteve të qendrave shëndetësore (cilësi shërbimi), ndërsa 28.8 % e tyre e vlerësojnë shërbimin shëndetësorë ekzistues.
- Shpenzimet për ilaçe janë më të ulëta për të anketuarit nga zonat rurale, krahasuar me ato të zonave urbane me të ardhura të ulëta deri në 10,000 lekë dhe janë më të mëdha për kategoritë me midis 10,001 lekë deri 70,000 lekë dhe ulen për kategoritë me të ardhurave mbi 70,000 lekë.
- Shumica e të intervistuarve (55.4%) deklarojnë se gjendja e tyre shëndetësore është mesatarisht njësoj me vitin e kaluar, por 36% mendojnë se gjendja e tyre është përkeqësuar.

Nuk ekziston një asistencë e vërtetë gjeriatrike dhe as kurse specializimi për mjekë të kësaj fushe. Edhe sistemi i kujdesjes në shtëpi është në fillimet e saj. Sipas traditës, kujdesi i të moshuarve i besohet familjes, por në përgjithësi kushtet e tyre të jetës janë kritike.

10

- Sipas vrojtimit për problemet e të moshuarve, 83.7% e të anketuarve vuajnë nga një sëmundje (85.6% në zonat rurale dhe 82.8% në zonat urbane).
  - Më të prekur nga sëmundjet është grupmosha 66-70 vjeç e ndjekur nga kategoria e moshës 61-65 vjeç.
  - Të anketuarit vuajnë në masën 58.6% nga një sëmundje kronike, por 41.4% e tyre vuan dhe nga më shumë se një sëmundje kronike. Tendencë është gati identike si për zonat urbane dhe zonat rurale.
  - Me rritjen e moshës, të moshuarit vuajnë nga më shumë se një sëmundje kronike, sidomos për ata me moshë mbi 71 vjeç.
  - Të anketuarit mendojnë se është e nevojshme asistencë/kujdestari në masën 36 % dhe pjesërisht në masën 20.8%, por 43.2% e të moshuarve mendojnë se ky shërbim nuk është i nevojshëm. Kjo asistencë është gjithmonë e më e nevojshme për të anketuarit që janë pjesë e kategorive 76 vjeç e sipër.
- Sipas vrojtimit për problemet e moshimit, të anketuarit shprehen për vlerësimin e shërbimit shëndetësor në poliklinika:
- 44.6% e të anketuarve deklarojnë se nuk janë as të pakënaqur, as të kënaqur (zonat rurale 59.5 % dhe në zonat rurale 38%).
  - 28.8% janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur.
  - 26.5% deklarohen si të kënaqur ose shumë të kënaqur . Në zonat urbane janë më të kënaqur në raport me zonat rurale sepse në poliklinika shërbimi është më i mirë në raport me atë në zonat rurale.
- Për vlerësimin e shërbimit shëndetësor në spitale:
- 36 % janë shumë të pakënaqur dhe të pakënaqur krahasuar me 19.7% që janë të kënaqur ose shumë të kënaqur nga shërbimi shëndetësor në poliklinika.
  - Në zonat urbane 22.8% janë të kënaqur kundrejt 12.6% që janë intervistuesit në zonat rurale.
- Për skemën e rimbursimit të ilaçeve:
- 69.5% e të anketuarve shprehen si shumë të pakënaqur ose të pakënaqur.
  - 30.5% kanë një vlerësim mesatar ose të kënaqshëm. Si në zonat rurale dhe urbane kanë afërsisht të njëjtën përqindje vlerësimi.

1.7.2 Personat e moshuar dhe paaftësia. Mundësitë e mospërmirësimit dhe të kufizimit të aftësive rriten me rritjen e moshës. Gratë e moshuara janë veçanërisht të ekspozuara ndaj aftësisë së kufizuar në moshën e pleqërisë për shkak të diferencave gjinore në jetëgjatësi dhe në sëmundshmëri si dhe në pabarazitë gjinore gjatë gjithë jetës. Efektet e mospërmirësimit dhe të aftësisë së kufizuar shpesh rëndohen nga stereotipet negative mbi personat me aftësi të kufizuar, që rezultojnë në shpresa të pakta për aftësimin e tyre si dhe në politika sociale që nuk i lejojnë ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Në këto rrethana sigurimi i shërbimeve mbështetëse për personat e moshuar, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuar, nxitin pavarësinë dhe fuqizimin e tyre për të marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës së shoqërisë. Moshimi i personave me aftësi të kufizuar të lindur duhet të jetë një prioritet për t'u përfshirë në programet zhvilluese.

Shtrimi në spitale shpesh mendohet dhe praktikohet si forma më e mirë për të moshuarit, gjë e cila në mjaft raste nuk sjell përmirësime, por pasoja negative për shëndetin e të moshuarve. Problemet e asistencës, pa marrë parasysh parandalimin, shkaktojnë në radhë të parë një rritje të riskut të sëmundjeve, prej nga sëmundjet kronike dhe shpesh edhe invaliditet në fazë të avancuar.

Problemet më të zakonshme tek të moshuarit janë: i) rënia muksulare; ii) osteoporoza; iii) prekje e shqisave; iv) kequshqyerja; v) sëmundjet kronike; vii) shëndeti mendor.

<sup>10</sup> Vrojtım: “Mbi problemet e moshimit në mbështetje të hartimit të dokumentit strategjik të moshimit”, MPCSSHB, 2008,

### 1.8 Garantimi dhe mjedisi lehtësues dhe mbështetës <sup>11</sup>

Banimit dhe mjedisit i jetesës. Me regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave 2001, rezultojnë se: peshat specifike të banesave me ngrohje qendrore është vetëm 1%, ndërkohë që në vendet e tjera të Europës ky tregues shkon nga 13-100%. Në vendin tonë 56.5% e banesave ngrohen me dru zjarri, 27% me energji elektrike dhe 15% me gaz.

Furnizimi me ujë. Në rreth 50% të ndërtesave e kanë ujin brenda ndërtesës (në qytet 86% dhe në fshat 15.5%), por uji është me ndërprerje. Në vendet e tjera të Europës ky tregues është 75-100%. Treguesi i peshës specifike të banesave që e kanë ujin brenda është njëra anë, ndërkohë që në shumicën e qyteteve nuk ka ujë pa ndërprerje për 24 orë.

Gjendja higjieno-sanitare. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2001, vetëm 55.1% e banesave kanë WC brenda banesës ndërsa pjesa tjetër sidomos në zonat rurale jashtë banesës. Në bazë të të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë rezultojnë se rreth 90 mijë familje janë me një ose me 2 anëtarë (35 mijë me një anëtar dhe 57 mijë me 2 anëtarë). Këto janë kryesisht familje të moshuarve që fëmijët e tyre kanë emigruar jashtë. Kjo përbën një problem të madh social, për të cilat shteti dhe shoqëria civile duhet të programojnë masa dhe politika efektive për mbështetjen e tyre me shërbime shëndetësore, shërbime sociale dhe reduktimin e varfërisë.

### 1.9 Kujdesi dhe mbështetja e personave që ofrojnë mbështetje

<sup>12</sup>

Sipas vërtetimit për problemet e moshimit, rezultojnë se rreth:

- 65.7% kanë burime suplementare të ardhurash (zonat rurale 70.3%, ndërsa ato në zonat urbane në 63.6%).
- Kjo tregon se të anketuarit, pavarësisht pagesave të ulëta të pensioneve, sigurojnë të ardhurat suplementare nga burime të tjera si: emigracioni, pronat, bujqësia etj.
- Burimet e të ardhurave suplementare në 31% të rasteve janë nga brenda vendit dhe 21.9% nga fëmijët emigrantë. Në zonat rurale, ku dhe varfëria është më e madhe, dërgesat nga fëmijët emigrantë zënë peshën kryesore në raport me të ardhurat e tjera nga prona apo puna.
- Duke pasur parasysh dhe se 50% e të anketuarve janë femra rezultojnë se 23.9% e tyre përgjigjen se organizojnë kohën ditore për mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë, ndërsa 28.5% nuk angazhohen për këtë qëllim.

### 1.10 Neglizhenca, abuzimi dhe dhuna

Në kontekstin e shoqërisë sonë është e vështirë për të identifikuar problemet e dhunës, të neglizhencës apo të abuzimit në grupin social të të moshuarve. Kjo për shkak të mentalitetit, traditës së vjetër të mbajtjes brenda familjes të problemeve të tilla, si dhe të nivelit kulturor në përgjithësi të shoqërisë dhe shkallës së hapjes së saj.

Sipas vërtetimit për problemet e moshimit, dhuna në 25% të rasteve është ushtruar nga nusja, 18.8% nga bashkëshorti/tja, 12.5% nga vajza/djali po ashtu dhe nga të afërmit dhe nipi.

- Dhuna psikologjike përbën 43.8% të rasteve, 18.8% fyerje, 6.3% dhunë fizike. Të anketuarit në masën 95.6% shprehën se nuk është ushtruar dhunë mbi ta gjatë këtij viti, por ekziston një përqindje prej 4.4% e cila deklaron të kundërtën dhe kjo karakteristikë është pak a shumë e njëjtë si në zonat urbane, po ashtu dhe në ato rurale.
- Pavarësisht gjinisë së të anketuarve, ata paraqesin karakteristikë të njëjta lidhur me faktin nëse është ushtruar dhunë mbi ta gjatë këtij viti, duke ekzistuar vetëm një ndryshim i vogël në përqindjet e të anketuarve femrat të cilat deklarojnë ushtrimin e dhunës si të shpeshtë në masën 1.7% krahasuar me meshkujt.

### 1.11 Imazhi i personave të moshuar

Personat e moshuar tradicionalisht janë respektuar dhe janë vlerësuar për autoritetin e tyre, për mençurinë, për dinjitetin dhe eksperiencën e grumbulluar gjatë jetës. Këto vlera shpesh neglizhohen, dhe personat e moshuar shpesh paraqiten si barrë për ekonominë për të cilët duhen ofruar shërbime sociale dhe shëndetësore.

Personat e moshuar zakonisht moshohen me shëndet të mirë, por ka dhe shumë prej tyre që kërkojnë shërbime shëndetësore e përkujdesje, ndaj shpesh krijohet një imazh negativ për të moshuarit, për pensionistët.

<sup>11</sup> Enti Kombëtar i Banesave

<sup>12</sup> Vërtetim "Mbi problemet e moshimit në mbështetje të hartimit të dokumentit strategjik të moshimit", MPCSSHB, 2008,

Veçanërisht gratë e moshuara janë viktimat të stereotipave negative: në vend që të paraqiten me vlera për kontributet e tyre, për aftësitë, për shpirtin njerëzor dhe cilësitë humane, shpesh ato paraqiten si të dobëta dhe të prulura dhe për pasojë, pranojnë praktikën e përjashtimit në nivel lokal e kombëtar.

## KAPITULLI II QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

### 2.1 Vizioni

VIZIONI I KËTIJ DOKUMENTI ËSHTË NË PËRPUTHJE ME VIZIONIN NDËRKOMBËTAR “PËR NJË SHOQËRI TË TË GJITHA MOSHAVE”

Të moshuarit kanë vlerësimin më të lartë dhe konsiderohen si pjesë integrale e familjes, e komunitetit, të barabartë në një shoqëri që çmon vlerat, njohuritë, kontributin dhe inkurajon përfshirjen në jetën shoqërore.

Vizioni i dokumentit strategjik për të moshuarit bazohet në vlerat themelore të krijuara në shekuj, mbështetet në parimin se dinjiteti është i qenësishëm për të gjithë individët në shoqërinë demokratike dhe synon që të moshuarit të jenë pjesë integrale e shoqërisë.

### 2.2 Qëllimi i dokumentit

Dokumenti strategjik, ndërsektoral zhvillues i moshimit ka si qëllim të garantojë:

- respektin për të moshuarit në familje dhe në komunitet nëpërmjet krijimit të një sistemi efektiv dhe të përshtatshëm i cili integron rrjetin e shërbimeve për këtë kategori sociale.
- plotësimin e nevojave për të moshuarit nëpërmjet hartimit të programeve dhe buxhetimit të tyre në nivel qendror dhe vendor.
- shpërndarjen e informacionit dhe bashkërendimin e veprimtarive të edukimit publik në dobi të të moshuarve.

- ofrimin e asistencës së nevojshme në nivel kombëtar dhe vendor të organizatave dhe aktorëve të ndryshëm për të lehtësuar zbatimin e politikave dhe shërbimit për të moshuarit.

- ndërmarrjen e kërkimeve, analizave dhe programeve të zhvillimit, të cilat përfshijnë njohuritë dhe modelet e reja që përmirësojnë cilësinë e jetës dhe ofrojnë shërbime shëndetësore, sociale dhe përhapjen e praktikave më të mira në nivel komunitar.

### 2.3 Prioritetet strategjike

- Zgjerimi i pjesëmarrjes dhe rritja e kontributit të personave të moshuar në proceset e zhvillimit të shoqërisë dhe në hartimin dhe zbatimin e politikave për zbutjen e varfërisë.

- Përmirësimi i shërbimit shëndetësor, mbulimi me shërbime shëndetësore e sociale duke garantuar trajtim të barabartë për personat e moshuar.

- Garantimi i një mjedisi lehtësues dhe mbështetës të komunitetit dhe pushtetit vendor për personat e moshuar duke parandaluar diskriminimin, dhunën e neglizhencën.

### 2.4 Dokumenti strategjik i moshimit bazohet në:

- njohjen e problematikës, dëgjimin e zërit të të moshuarve, të personave që kujdesen për ta dhe bashkëshortëve të cilët iu shërbejnë atyre;

- respektimin e dinamikës së ndryshimit të nevojave dhe preferencave specifike të popullsisë së moshuar;

- përcaktimin e indikatorëve, ndryshimeve në praktikën publike që ndiqen e ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mirëqenien e përgjithshme të të moshuarve;

- prioritetet e qeverisë shqiptare dhe dokumentet ndërkombëtare për moshën e tretë.

### 2.5 Përputhshmëria dhe ndërveprimi i strategjisë

2.5.1 Dokumenti i politikave për të moshuarit, objektivat dhe veprimet e parashikuara në planin e veprimit janë bërë në përputhje me planin e veprimit të Madridit<sup>13</sup> dhe dokumentet strategjike evropiane dhe ndërkombëtare.

13 Deklarata e Madridit „Për moshimin”, dhe politikën sociale të Qeverisë

### 2.5.2 Përputhshmëria me strategjitë e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale

Në përputhje me Strategjinë sektoriale të mbrojtjes sociale objektivat kryesorë për shërbimet për të moshuarit do të jenë:

- i) zgjerimi i llojshmërisë së shërbimeve social mjekësore rezidenciale e komunitare për të moshuarit;
- ii) shtrirja e shërbimeve komunitare deri në vitin 2013 edhe në bashkitë që aktualisht nuk kanë shërbime të tilla për të moshuarit;
- iii) zgjerimi i modelit të shërbimeve në “familje” për të moshuarit e vetmuar;
- iv) implementimi i standardeve të shërbimeve për të moshuarit dhe rritja e cilësisë së shërbimeve;
- v) licencimi i të gjitha OJF-ve që ofrojnë shërbime për të moshuarit.

## KAPITULLI III POLITIKAT

### Drejtimi 1: Personat e moshuar dhe zhvillimi

#### 3.1.1 Pjesëmarrja aktive në shoqëri dhe në zhvillim

Pjesëmarrja aktive për të gjithë moshat përfshin krijimin e mundësive për personat e moshuar që të vazhdojnë të kontribuojnë në shoqëri. Kontributi social ekonomik i të moshuarve realizohet përmjet pjesëmarrjes së tyre në veprimtaritë ekonomike. Ata shpesh luajnë rol aktiv në familje dhe në jetën ekonomiko-sociale të komunitetit. Ata japin kontribute të mëdha që është vështirë të maten vetëm në terma ekonomikë: kujdesi për pjesëtarët e familjes, roli në punën produktive ndihmëse, në mbajtjen e ekonomisë së familjes dhe në veprimtaritë vullnetare në komunitet që kontribuojnë në përgatitjen e forcës së ardhshme punëtore.

Të gjitha këto kontribute në sektorë të ndryshëm, përfshirë edhe ato në punën e papaguar (sektori informal) të të gjithë moshave, veçanërisht të grave, duhet të vlerësohen.

Personat e moshuar duke qenë pjesëmarrës aktivë në procesin e zhvillimit duhet të jenë edhe përfitues. Të gjithë kanë të drejta për të përfituar nga zhvillimi. Ndikimi i të moshuarve në zhvillimin ekonomiko-social të shoqërisë diktojnë nevojën për marrjen e masave për integrimin dhe fuqizimin e personave të moshuar. Përveç kësaj, migrimi, urbanizimi, transformimi nga familje të mëdha në të vogla, familjet lëvizëse, mungesa e aksesit në teknologji, mund të marginalizojnë të moshuarit nga përshpejtimi i zhvillimit e rrjedhimisht të zbehin qëllimisht rolin e tyre ekonomik e social duke dobësuar edhe burimin tradicional të mbështetjes së tyre.

Pjesëmarrja në aktivitetet sociale, ekonomike, kulturore, sportive, rekreative e vullnetare kontribuon në rritjen dhe ruajtjen e mirëqenies personale. Organizatat, shoqatat e personave të moshuar mbeten një faktor i rëndësishëm për të sensibilizuar opinionin, promovimin dhe forcimin e bashkëveprimit të brezave.

#### 3.1.2 Punësimi i personave të moshuar

Emigrimi dhe migrimi i brendshëm është shoqëruar me një përqendrim të lartë të personave të moshuar në zonat rurale të cilët janë të detyruar të punojnë për të siguruar të ardhura për të plotësuar pensionet e ulëta që marrin aktualisht.

Për shkak të diskriminimit të popullsisë fshatare një nga objektivat është edhe rritja e mundësive për punësim në këto zona, jo vetëm duke u mbështetur në aktivitetin bujqësor, por edhe në aktivitete jobujqësore si në krijimin ndërmarrjeve familjare apo bizneset e vogla, me aktivitete të cilat plotësojnë sektorin e bujqësisë si: turizmi, përpunimi dhe zëjtaria lokale, agrobiznesi etj. Rritja e mundësive për punësim do të ndikonte në tërheqjen e të rinjve dhe grave duke stimuluar qëndrimin dhe rikthimin në këto zona të grupeve të ndryshme të popullsisë. Në këtë këndvështrim do të ishte me shumë vlerë gërshtimi i përvojës së personave të moshuar dhe angazhimi i të rinjve në procesin e zhvillimit rural dhe në ruajtjen e traditave

Në sektorin privat jobujqësor pjesëmarrja në punë e personave të moshuar është e konsiderueshme. Një pjesë e këtyre bizneseve janë familjare ku punojnë anëtarët e familjes dhe përvoja e tyre shpesh shikohet si një avantazh specifik për firmën. Largimi i tyre nga vendi i punës bëhet për shkak se shikohen si të kushtueshëm dhe jo fleksibël ndaj ndryshimeve të reja teknologjike dhe organizative. Prandaj përshtatja e tyre me teknologjitë e reja kërkon organizimin e kurseve kualifikuese dhe të trajnimeve. Angazhimi i personave të moshuar në tregun informal lidhet me mospagimin e

kontributit të sigurimeve shoqërore nga punëdhënësit. Kjo kërkon rishikimin e skemës së sigurimeve shoqërore në lidhje me masën e përfshirjes së kontributit shtesë të personave të moshuar që kanë dalë në pension në vlerën përfundimtare të pensionit e cila do të ndikonte në minimizimin e punës informale të këtij grupimi.

Objektivat:

- Zgjerimi i mundësive për punësim dhe respektimi i të drejtave të personave të moshuar për t'u trajtuar njëjloj si gjithë punonjësit e tjerë.

- Vlerësimi i kontributit dhe përvojës së personave të moshuar dhe përfshirja e tyre në proceset e zhvillimit të shoqërisë.

- Zgjerimi i mundësive për personat e moshuar për t'u angazhuar në jetën kulturore, ekonomike, politike, sociale etj.

- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar duke ndërmarrë nisma në përputhje me detyrimet e konventave për të drejtat e njeriut, Planit ndërkombëtar për veprim mbi moshimin dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtare.

### 3.1.3 Solidariteti ndërmjet brezave

Çdo brez mbështetet mbi kontribute të bëra prej brezave të mëparshëm. Personat më të vjetër mund të jenë bartës të kulturave ose të traditave unike. Në të njëjtën kohë çdo brez sjell aftësi të njëjta ose kualitete ku të vjetrit janë i vetmi grup që kanë jetuar përmes shumë përvojave që brezat më të rinj akoma nuk i kanë përballur dhe mund të shërbejnë si modele të vlefshme. I riu sjell një energji të veçantë dhe entuziazëm në jetë nga i cili të vjetrit mund të përfitojnë. Disa prej aftësive të tyre tipike, të tilla si njohja e teknologjive më të fundit mund të jenë shumë të përdorshme për njerëzit më të vjetër.

Tema e zgjedhur për vitin ndërkombëtar të të moshuarve, 1999, drejt një shoqërie për të gjitha moshat, sugjeroi një fokus më të gjerë sesa njerëzit më të vjetër.

Në thelb tema drejt një shoqërie për të gjitha moshat është një mundësi për t'u bërë të vetëdijshëm që personat më të vjetër kanë të njëjtat nevoja dhe interesa, siç kanë të gjithë njerëzit. Investimet për një moshë të vjetër, të plotë, të shëndetshëm bëhen që të vihen në jetë prej vendimeve tona, ashtu dhe nëpërmjet politikave sociale dhe strukturave mbështetëse.

Objekti:

Forcimi i solidaritetit përmes barazisë dhe reciprocitetit midis brezave.

### 3.1.4 Zhvillimi rural, migrimi dhe urbanizimi

Sipas Anketës së buxhetit të familjes (2007), realizuar nga INSTAT-i, në zonat rurale shpenzimet për transport zënë 6.7 për qind, kundrejt 5.8 për qind në zonat urbane.

Shpenzimet e kujdesit shëndetësor zënë 4.4 për qind kundrejt 3.8 për qind në zonat urbane, si dhe mirëmbajtje dhe mobilim i banesës 4.4 kundrejt 3.8 për qind. Në të kundërt në një nivel më të ulët janë shpenzimet për pajisjen me soba gatimi me gaz, sigurimin e ujit, energjisë elektrike etj.

Si rezultat i emigrimit dhe imigrimit kemi më shumë persona të moshuar që jetojnë të vetmuar dhe në lidhje me këtë grup të popullsisë rurale, konstatohet mungesë e theksuar e shërbimeve shëndetësore dhe sociale në ndihmë të kësaj kategorie. Përqendrimi i popullsisë migratore, si dhe një pjesë të personave të moshuar që kanë migruar në zonat e urbanizuara duhet që t'u përshtaten kushteve të jetesës së re urbane.

Gjithashtu është e nevojshme rritja e kontributit të pushtetit vendor, si dhe e shoqërisë civile në mbështetjen e këtij grupi duke u angazhuar në ndërmarrjen e programeve të veçanta mbështetëse që mundësojnë pjesëmarrjen e tyre në procese të ndryshme të zhvillimit komunitar.

Objektivat:

- Përmirësimi i mëtejshëm i kushteve të jetesës dhe të infrastrukturës në zonat rurale

- Zbutja e marginalizimit të personave të moshuar në zonat rurale.

### 3.1.5 Sigurimi shoqëror, mbrojtja sociale dhe parandalimi i varfërisë

Me strategjinë e shërbimeve sociale synohet të krijohet një sistem shërbimesh që u përgjigjen nevojave të përfituesve dhe që minimizojnë impaktin e aspekteve negative të shoqërisë mbi kategoritë target të këtyre shërbimeve. Në këtë mënyrë bëhet i mundur mosdiskriminimi dhe përfshirja, garantohet që personat të jenë gjithnjë të mbështetur brenda familjeve dhe komuniteteve të tyre, por gjithashtu edhe rritet cilësia e kujdesjes që u ofrohet në qendrat rezidenciale. Sistemi i shërbimeve sociale moderne dallohet nga fakti që është në gjendje të mbështesë dhe të gjejë përgjigje për nevojat e individëve. Shërbime sociale për të gjitha grupet në nevojë ofrohen në qendra rezidenciale dhe aktualisht edhe shërbime në qendrat ditore komunitare.

Decentralizimi i shërbimeve dhe deinstitutionalizimi tashmë përbëjnë një mundësi shumë të mirë për: nxitjen dhe promovimin e shërbimeve të reja që u përgjigjen më mirë nevojave lokale; stimulimin e administratorëve lokalë dhe shoqërinë civile që të bëhen protagonistë të qeverisjes në të gjithë territorin. Këto shërbime tashmë menaxhohen nga pushteti vendor.

Shërbimet sociale rezidenciale dhe ditore të ofruara nga aktorët publikë apo privatë duhet të garantojnë shërbime në përputhje me standardet e miratuara për secilin grup në nevojë.

Kualifikimi dhe rikualifikimi profesional i aktorëve që veprojnë në fushën e shërbimeve sociale përbën një ndër sfidat për të ardhmen.

Aktualisht funksionojnë 5 shtëpi për të moshuarit që financohen nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (Tiranë, Shkodër, Kavajë, Fier dhe Gjirokastrë) dhe dy qendra polivalente gjysmërezidenciale në (Tiranë dhe Sarandë) me një kapacitet pritës 450 persona. Po ashtu janë ngritur edhe 18 shërbime ditore komunitare për të moshuarit që administrohen nga bashkitë/komunat.

Mbështetur në rritjen e qëndrueshme të PBB-së, situatën pozitive demografike, rritjen graduale të moshës së daljes në pension, barazimin e përfitimeve midis kontribuesve të fermerëve me ato të personave të vetëpunësuar në aktivitete jobujqësore dhe përmirësimet e rregullave dhe procedurave të mbledhjes së të ardhurave duhet të ndërmerren disa masa si:

- Vendosja e elementeve nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes dhe të pagesës së kontributeve mbi pagat reale duke eliminuar faktorët që kanë çuar në shkëputjen e madhësisë së kontributit nga madhësia e pensionit sidomos në rastet e kontribuesve me pagë mbi mesataren.

- Përmirësimi i formulës së indeksimit të pensioneve dhe abrogimin e rregullave që çojnë në erozion të shpejtë të shkallës së zëvendësimit, pra të raportit midis pagës dhe pensionit.

- Rritja e mëtejshme e qëndrueshmërisë financiare dhe përmes saj garantimi dhe vetëfeksionimi financiar i skemës së sigurimeve shoqërore.

- Përdorimi i metodave efikase për evidentimin e popullsisë aktive dhe marrëdhënieve ekonomike ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve, administrimi me efikasitet të lartë dhe të sigurt i fondit të sigurimeve shoqërore.

Masat e mësipërme do të ndikojnë në solidaritetin e brezave, si dhe krijimin e mundësive për të zgjeruar e rritur cilësinë e mbrojtjes së të moshuarve.

Objektivat:

- Të programohet modeli i shërbimit të kujdestarisë për të moshuarit, duke siguruar pagën bazë dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

- Garantimi i një minimumi të mjaftueshëm të ardhurash për të gjithë personat e moshuar veçanërisht për grupet e pafavorizuara në planin social dhe ekonomik.

Drejtimi 2: Shëndeti dhe mirëqenia për personat e moshuar

3.2.1 Akses i barabartë në shërbimet shëndetësore<sup>14</sup>

Në vitin 2004 rreth 43% e të moshuarve të anketuar (mosha 65 e lart) në Tiranë kërkuar kujdes mjekësor duke iu drejtuar poliklinikave, ndërsa rreth 12% e tyre referuan që s'kishin pasur nevojë për ndjekje dhe kishin një gjendje shëndetësore të kënaqshme. Në qershor 2008 rezultoi se 81.2 % e pacientëve të moshës 55- 90 vjeç bëjnë shëtitje në ajër të pastër dhe një stil aktiv të jetës, 58.6% vuajnë nga një sëmundje kronike dhe 41.4 % me dy sëmundje. Vizitat e tyre pa shkak për kontrolle periodike tek mjeku i familjes janë në masën 75.9 % të ndara në: 1 herë në vit 6%, dy herë në vit 5 % dhe më shumë se 2 herë në vit në masën 13%.

Ndërhyrjet dhe politikat shëndetësore të organizuara duhet të orientohen drejt sigurimit të aksesit, masave parandaluese dhe shëndetësore për të siguruar një mirëqenie fizike, mendore dhe sociale për moshën e tretë.

Objektivi:

- Përmirësimi dhe qëndrueshmëria e gjendjes shëndetësore dhe stili i jetesës mes individëve të moshuar, duke parashikuar ndërhyrjet shëndetësore në mënyrën e duhur në akses e cilësi.

- Rritja e kapacitetit të specialistëve dhe personelit shëndetësor për plotësimin e nevojave të personave të moshuar.

---

<sup>14</sup> Raporti i Ministrisë së Shëndetësisë

### 3.2.2 Personat e moshuar dhe paaftësia

Me rritjen e moshës ngadalësohen mundësitë e përmirësimit dhe kufizimit të aftësive. Gratë e moshuara janë veçanërisht të ekspozuara ndaj aftësisë së kufizuar në moshën e pleqërisë për shkak të diferencave gjinore në jetëgjatësi dhe në sëmundshmëri, si dhe në pabarazitë gjinore gjatë gjithë jetës. Efektet e mospërmirësimit dhe të aftësisë së kufizuar shpesh rëndohen nga qëndrimet e krijuara (stereotipat) negative mbi personat me aftësi të kufizuar, që rezultojnë në shpresa të pakta për aftësimin e tyre, si dhe në politika sociale që nuk i lejojnë ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Në këto rrethana është i domosdoshëm sigurimi i ndërhyrjeve dhe krijimi i mjediseve mbështetëse për të gjithë personat e moshuar, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuar, për të nxitur pavarësinë dhe fuqizimin e tyre për të marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës së shoqërisë. Moshimi i personave me aftësi të kufizuar të lindur është faktor që duhet të merret në konsideratë në proceset e planifikimit dhe të vendimmarrjes.

Personat e moshuar me aftësi të kufizuar e kanë riskun e varfërisë shumë më të madh se sa të moshuarit e zakonshëm, për shkak të diskriminimit në vendin e punës, diskriminimin nga punëdhënësit dhe neglizhencën për plotësimin e nevojave të tyre në vendin e punës.

Objektivi:

- Ruajtja e kapacitetit funksional gjatë gjithë jetës dhe nxitja e pjesëmarrjes të personave të moshuar me aftësi të kufizuar në jetën shoqërore.

Drejtimi 3: Garantimi dhe mjedisi lehtësues dhe mbështetës

#### 3.3.1 Banimi dhe mjedisi i jetës

Strehimi dhe mjedisi rrethues ndikojnë në shëndetin dhe cilësinë e jetës si: sipërfaqja e banimit që kanë në dispozicion, aksesin ndaj ujit, sistemi i ngrohjes, energjia elektrike, shërbimi telefonik, mundësitë financiare, gjendja higjieno-sanitare dhe lehtësitë e telekomunikacionit etj.

Në ndihmë të personave të moshuar zbatohen disa masa si: kompensimi i energjisë elektrike apo udhëtimit urban falas për një kategori pensionistësh (për veteranët), por këto masa nuk përfshijnë një numër nevojash, sidomos për të moshuarit në zonat rurale apo të moshuarit e vetmuar të cilët nuk janë në gjendje të administrojnë shtëpinë apo të kujdesen për vete.

Objektivat:

- Të sigurohen lehtësira transporti për personat e moshuar në të gjithë territorin e vendit dhe të zgjerohet rrethi i të moshuarve që përfitojnë nga këto lehtësira.

- Të mbikëqyret favorizimi i “moshimit në vend”- në komunitet, në përputhje me preferencat individuale dhe mundësinë për strehim të përbalueshëm për të moshuarit.

#### 3.3.2 Kujdesi dhe mbështetja e personave që ofrojnë mbështetje

Kujdesi për nevojat e personave të moshuar jepet kryesisht nga familja. Në vendin tonë megjithëse i është dhënë një rëndësi shtrirjes së sistemit të shërbimeve sociale për personat e moshuar në të gjithë vendin, numri i tyre është i pamjaftueshëm. Kjo grupmoshë në realitetin e sotëm përballet me nevojën për mbështetje dhe asistencë sociale dhe shëndetësore nga njëra anë, por nga ana tjetër shpesh luan një rol të rëndësishëm në përkujdesin për pjesëtarë të tjerë të familjes.

Kujdesi familjar pa shpërblim për personat që ofrojnë shërbimin e kujdestarisë për të moshuarit krijon vështirësi të reja ekonomiko-financiare në familje. Këtë shërbim për të moshuarit e realizojnë gratë për të cilat duhen ndërtuar politika të reja për mbështetjen, shpërblim për shërbimin që ofrojnë.

Gratë e moshuara vuajnë penalizimin financiar të kontributeve të ulëta për pensionet, për arsye të mungesës në tregun e punës, dhe të të ardhurave të pakta. Ato gjithashtu vuajnë kostot e stresit fizik dhe emocional për arsye të shpërndarjes jo të barabartë të përgjegjësisë familjare, si dhe përgjegjësisë për përkujdesje njëkohësisht për fëmijët dhe të moshuarit.

Objektivat:

- Të sigurohen burimet e nevojshme për përkujdesje dhe shërbime të vazhdueshme për personat e moshuar dhe mbështetjen e kujdestarisë.

- Të mbështeten personat e moshuar, veçanërisht gratë si ofrues shërbimesh.

#### 3.3.3 Neglizhenca, abuzimi dhe dhuna

Abuzimi dhe dhuna ndaj personave të moshuar është fizike, psikologjike, emocionale, financiare dhe ka një shtrirje në të gjitha nivelet sociale dhe në të gjitha zonat e vendit. Dhuna dhe abuzimi është një fenomen i përhapur me të cilin po përballet shoqëria e sotme shqiptare.

Gratë e moshuara janë grupi më i prekur nga dhuna, sepse mbi to rëndon më shumë edhe varfëria që lidhet me mungesën e aksesit në burimet ekonomike, që përfshijnë kreditë, pronësinë mbi tokën dhe trashëgiminë, mungesën e aksesit në edukim e në shërbimet mbështetëse dhe nga pjesëmarrja e tyre minimale në procesin e vendimmarrjes. Mbi personat e moshuar rëndon edhe neglizhenca brenda në familje në komunitet dhe nga institucionet publike.

Objektivat:

- Të garantohet sistemi ligjor, shërbimi shëndetësor psikologjik dhe social për parandalimin dhe eliminimin e dhunës, neglizhencës dhe abuzimit.

- Të punohet me të moshuarit, familjet dhe komunitetin për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të braktisjes, keqtrajtimit dhe dhunës ndaj personave të moshuar.

#### 3.3.4 Imazhi i personave të moshuar

Shoqëria mund të bëjë shumë për të inkurajuar median në vlerësimin e të gjitha moshave, nëpërmjet portretizimeve reale të njerëzve, promovimit të diversitetit të nevojave dhe interesave midis e brenda grupmoshave, nxitjes së respektit për praktikat shpirtërore e kulturore të ndryshme, krijimit të një ambienti aftësimi që inkurajon personat e moshuar për të vënë në përdorim gjithë aftësitë e tyre për mirëqenien e vetes së tyre, familjes dhe shoqërisë, për të vlerësuar punën e tyre vullnetare dhe të kujdesit.

Objektivi:

- Përmirësimi i perceptimit nga publiku i vlerave të personave të moshuar, i autoritetit, mençurisë, produktivitetit dhe i kontributeve të tyre.

## KAPITULLI IV LLOGARIDHËNIA DHE MONITORIMI

### 1. Zbatimi

Për zbatimin e Dokumentit ndërsektorial zhvillues për moshimin, institucioni kryesor përgjegjës është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Brenda organikës së kësaj ministrie do të ngrihet një strukturë e re për hartimin, zbatimin e politikave për moshimin, monitorimin, si dhe koordinimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve për realizimin e objektivave të këtij dokumenti.

Institucione të tjera përgjegjëse për zbatim janë: Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me institucionet në vartësi të tyre.

Në procesin e zbatimit të DNZHM-së një rol të rëndësishëm kanë edhe njësitë e qeverisjes vendore.

### 2. Monitorimi

Për monitorimin e DNZHM-së parashikohet ngritja e Sekretariatit për Monitorim brenda strukturës respektive në MPÇSSHB.

Do të ketë një vlerësim të strukturave konsultuese në nivel qendror dhe vendor pas rishikimit të legjislacionit për personat e moshuar.

**PLANI I VEPRIMIT I DNZHM-SË**

| <b>QËLLIMET<br/>STRATEGJIKE</b>                                                          | <b>OBJEKTIVAT<br/>SPECIFIKE</b>                                                                                                                                      | <b>VEPRIMET</b>                                                                                                                                                                          | <b>INSTITUCIONET<br/>PËRGJEGJËSE</b>                 | <b>AFATET</b>         | <b>BUXHETI NE<br/>000/LEKE</b> | <b>DONATORET</b> | <b>TREGUESIT E<br/>MONITORIMIT</b>                                         |
|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|-----------------------|--------------------------------|------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| 1.1. Ngritja dhe forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për personat e moshuar | 1.1.1<br>Ngritja dhe forcimi i mekanizmave institucionalë në nivel qendror dhe vendor për zbatimin dhe monitorimin e Dokumentit Ndërsektorial Zhvillues për Moshimin | 1.1.1.1<br>Ngritja e një strukture shtetërore, për problemet e moshimit si hartues politikash, monitorues dhe koordinues me aktorët e tjerë                                              | MPCSSHB<br>KM                                        | 2009                  | <b>2,520</b>                   |                  | Ngritja dhe miratimi i strukturës për çështjet e moshimit                  |
|                                                                                          |                                                                                                                                                                      | 1.1.1.2<br>Përmirësimi i sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe analizës së statistikave dhe indikatorëve në lidhje me moshimin                                                           | MPCSSHB INSTAT<br><b>MINISTRITË E LINJËS</b><br>NJQV | 2009-2010             | <b>1,220</b>                   |                  | Mbledhja e statistikave për moshimin dhe përcaktimi i indikatorëve moshorë |
|                                                                                          | 1.1.2<br>Rishikimi i legjislacionit në mbështetje dhe zbatimit të të drejtave të personave të moshuar në përputhje me standardet ndërkombëtare                       | 1.1.2.1.<br>Hartimi i Statusit të të Moshuarit                                                                                                                                           | MPÇSSHB<br>OJF-të                                    | 2009<br>(6-mujori II) | <b>1,000</b>                   |                  | Miratimi i Statusit të të Moshuarit                                        |
|                                                                                          |                                                                                                                                                                      | 1.1.2.2<br>Realizimi i një studimi për evidentimin e boshllëqeve të legjislacionit ekzistues në lidhje me personat e moshuar dhe ndërmarrja e iniciativave të nevojshme në këtë drejtim. | MPCSSHB<br>SHSSH<br>ISSH<br>ISKSH<br>MSH<br>NJQV     | 2010                  | <b>3,000</b>                   |                  | Studimi dhe dalja me rekomandime konkrete                                  |

| <b>DREJTIMI : PERSONAT E MOSHUAR DHE ZHVILLIMI</b>                                      |                                                                                                |                                                                                                                                                                                       |                                                   |                                        |               |  |                                                                                                 |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------------|---------------|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 2.1.<br>Rritja e pjesëmarrjes aktive të personave të moshuar në shoqëri dhe në zhvillim | 2.1.1<br>Vlerësimi i kontributit social, kulturor, ekonomik dhe politik i personave të moshuar | 2.1.1.1<br>Fushata sensibilizuese për vlerësimin e kontributit të të moshuarve për krijimin dhe zhvillimin e lidhjeve të pushtetit vendor me publikun                                 | MPCSSHB<br>MTKRS<br>Akademia e Shkencës<br>OJF-të | 2009-2013                              | <b>35,000</b> |  | Nr. personash të sensibilizuar                                                                  |
|                                                                                         |                                                                                                | 2.1.1.2<br>Përfshirja e personave të moshuar në role këshilluese në komunitet dhe struktura publike nëpërmjet krijimit të bordeve këshillimore                                        | NJQV                                              | 2010<br>e në vijim                     | <b>10,000</b> |  | Nr. i njësive vendore ku ngrihen bordet këshillimore.<br>Nr. i të moshuarve të përfshirë        |
|                                                                                         |                                                                                                | 2.1.1.3<br>Informacion në nivel qendror dhe vendor për veprimtarinë, kontributin dhe gatishmërinë e këtyre personave për t'u përfshirë aktivisht në shoqëri                           | INSTAT<br>MPCSSHB<br>NJQV                         | 2009 e në vijim (informacion periodik) | <b>2,000</b>  |  | Nr. i aktiviteteve ;<br>Nr. i të moshuarve të përfshirë.                                        |
|                                                                                         |                                                                                                | 2.1.1.4<br>Fuqizimi i kapaciteteve të OJF-ve dhe qendrave që kanë në fokusin e tyre çështjet e personave të moshuar                                                                   | MPCSSHB<br>OJF-të<br>donatore                     | 2009-2013                              | <b>12,600</b> |  | Nr. i qendrave/OJF-ve që ofrojnë shërbime për personat e moshuar sipas standardeve të miratuara |
|                                                                                         |                                                                                                | 2.1.1.5<br>Promovimi i praktikave më të mira në përkrahjen dhe pjesëmarrjen e personave të moshuar për të ruajtur, transmetuar e zhvilluar më tej pozitiven në gjithë kuadrin e jetës | MPCSSHB<br>NJQV<br>OJF-të                         | 2010-2013                              | <b>10,000</b> |  | Numri i praktikave më të mira të promovuara                                                     |

|                                       |                                                                                                  |                                                                                                                                           |                                                                                     |                                           |               |  |                                                          |
|---------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|---------------|--|----------------------------------------------------------|
|                                       | 2.1.2.<br>Rritja e pjesëmarrjes së personave të moshuar në proceset e vendimmarrjes në çdo nivel | 2.1.2.1.<br>Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e qeverisjes qendrore nëpërmjet bordeve këshilluese                                     | Institucionet e qeverisjes qendrore OJF-të                                          | 2009-2013<br>(Fillon në 6-mujori I, 2009) | <b>1,000</b>  |  | Mbledhjet e bordeve dhe nr. i të moshuarve në këto borde |
|                                       |                                                                                                  | 2.1.2.2.<br>Krijimi i një rrjeti (web-site) për prezantimin, shpërndarjen e informacionit mbi çështjet e moshës së tretë                  | MPCSSHB bashkitë, komunat                                                           | 2010 (6-mujori I) në vazhdimësi           | <b>8,000</b>  |  | Persona të sensibilizuar                                 |
|                                       |                                                                                                  | 2.1.2.3.<br>Rishikimi i kurrikulave në të gjitha nivelet arsimore duke përfshirë çështjet psiko-sociale të moshimit                       | MASH MPCSSHB OJF-të Media                                                           | 2010-2011                                 | <b>15,000</b> |  |                                                          |
|                                       | 2.1.3.<br>Rritja e mundësive të punësimit të personave të moshuar që duan të punojnë             | 2.1.3.1<br>Inkurajimi i mundësive për punësimin part-time të personave të moshuar në tregun aktual të punës                               | MPÇSSHB Njësite e qeverisjes vendore Dhoma e Tregtisë/ Unioni i Dhomave të Tregtisë | 2010-2013                                 | <b>1,500</b>  |  | Nr. i të moshuarve të angazhuar në tregun e punës        |
|                                       |                                                                                                  | 2.1.3.2<br>Rishikimi i kriterëve përzgjedhëse për pozicione të lira pune apo për pozicione drejtuese veçanërisht në administratën publike | DAP Ministritë e linjës                                                             | 2011-2013                                 | <b>1,000</b>  |  | Kritere të miratuara                                     |
| 2.2.<br>Solidariteti ndërmjet brezave | 2.2.1<br>Forcimi i solidaritetit përmes barazisë dhe reciprocitetit midis brezave                | 2.2.1.1<br>Fushata sensibilizuese për rritjen e solidaritetit ndërmjet brezave                                                            | MPÇSSHB NJQV OJF-të                                                                 | 2009-2013                                 | <b>18,000</b> |  | Numri i fushatave<br>Numri i personave të sensibilizuar  |

|                                                                                        |                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                   |           |                |  |                                                                                              |
|----------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------|----------------|--|----------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                        |                                                                                 | 2.2.1.2<br>Implementimi i programeve ndërbreznore në disa zona pilot dhe më pas shtrirja e tyre në të gjithë territorin e vendit duke iu referuar kushteve të vendit, si dhe përvojave më të mira botërore                                                          | MPÇSSHB<br>MPB<br>NJQV<br>OJF-të<br>Donatorët                                     | 2009-2013 | <b>2,500</b>   |  | Numri i programeve<br><br>Numri i personave përfitues                                        |
|                                                                                        |                                                                                 | 2.2.1.3<br>Ngritja e shërbimeve komunitar për të moshuarit dhe të rinjtë për të sjellë ndryshime të perceptimeve të të moshuarve ndaj të rinjve                                                                                                                     | MPCSSHB<br>MTKRS<br>Njësiti vendore<br>OJF-të<br>Donatorët                        | 2010-2013 | <b>60,000</b>  |  | Nr. shërbimeve të ngritura<br>Numri i personave përfitues                                    |
